

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

**9.04.2024
Ora 12:04**

RENDI I DITËS

Projektvendime: “Për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj, z. K. Puleri.**

Parti Politike: Z. M. Logu (Koalicioni “Bashkë Fitojmë”)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, atëherë në seancën e sotme publike, kemi në rendin e ditës disa projektvendime që lidhen me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë. Respektivisht në Këshillin e Bashkisë Shkodër, në Këshillin e Bashkisë Berat, në Këshillin e Bashkisë Krujë, në Këshillin e Bashkisë Fier dhe në Këshillin e Bashkisë Kukës. Ndërkohë nga seancat e kaluara kemi të mbartuara:

- Projektvendimin “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”.

- Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kristian Luigj Shkreli, Kryetar Bashkie në Bashkinë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Këshillat e Bashkisë: Shkodër, Berat, Krujë, Maliq, Fier dhe Kukës, kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave në këshillat e tyre. Kandidatët vijues nga listat shumemërore të partive përkatëse që ju kalon mandati i këshilltarit, kanë plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se asnjë prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët përkatës, ku konstatohet se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Gjithashtu dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatëve, ku konstatohet se kandidatët nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Për sa më sipër në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Bashkisë: Shkodër, Berat, Krujë, Maliq, Fier dhe Kukës nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të partive? S'kemi?! Mirë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, zotin Fatmir Vojvoda.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*


- Plotësimin e vakancës, po në Këshillin e Bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, me zonjën Anita Amuli.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Berat, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zonjën Klejda Kusta.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Krujë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia e Gjelbër, zonjën Meri Zalla.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Maliq, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, zonjën Marjeta Xhelollari.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, zonjën Brunilda Çami.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kukës, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Agrare Ambientaliste të Shqipërisë, zotin Vebi Bajraktari.

Vendimet nr. 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

9.04.2024
Ora 12:09

RENDI I DITËS

**Projektvendim: “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve
financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik
2022”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj, z. K. Puleri.**

Parti Politike: Z. M. Logu (Koalicioni “Bashkë Fitojmë)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi që i është bërë raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Neni 23, i ligjit “Për partitë politike”, parashikon afatet e dorëzimit të raporteve financiare vjetore, mënyrën e dorëzimit të raporteve, si dhe publikimin e tyre. Gjithashtu parashikon dhe caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik. Në udhëzimin nr. 10, datë 21.4.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është përcaktuar mënyra se si partitë politike duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nisur nga sa më sipër është hartuar projektvendimi “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

raporteve financiare të partive politike për të ardenzimet për vitin kalendarik 2022”. Brenda datës 31 mars të vitit pasardhës partitë politike kanë detyrimin të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin financiar vjetor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në fillim të vitit kalendarik i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, numrin e partive politike të regjistruara në gjykatë. Në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë të regjistruara njëqind e tridhjetë e një parti politike. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë administruar dyzet e tetë raporte financiare të dorëzuara nga partitë politike. Pas dorëzimit të raporteve financiare nga partitë politike, KQZ caktoi me short ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2022. Ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) të përzgjedhur, referuar afateve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, depozituan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, raportet e auditimit për njëqind e tridhjetë e një parti politike. Pas administrimit të raporteve të mësimërme, KQZ evidentoi mospërputhje në lidhje me Ligjin “Për Partitë Politike”, si dhe aktet nënligjore si më poshtë vijon:

- Mosdorëzimi i raporteve financiare vjetore nga tetëdhjetë e tre parti politike;
- Moskryerjen e auditimit për shtatëdhjetë e gjashtë parti politike për shkak të adresave jo të sakta;
- Moskryerja e auditimit për shtatë parti politike pasi nuk kanë bashkëpunuar me audituesit ligjorë;
- Katër parti politike janë shpallur në listën e subjekteve me statusin pasiv nga organet tatimore. Gjatë mbledhjes së kaluar kemi pasur një e-mail nga Organizata KRIIK, e cila ka bërë disa rekomandime. Pasi u shqyrtuan dhe u verifikuan këto rekomandime, janë reflektuar në raportin e gjetjeve që po ju paraqesim më poshtë. Për shkelje të dispozitave që janë verifikuar dhe provuar nga administrata e KQZ-

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

së, kemi bërë dhe propozimet përkatëse për marrjen e masave administrative për çdo parti politike, nisur nga natyra e shkeljes së tyre. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe masat administrative të propozuara nga asministrata, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ndonjë diskutim përfaqësues të partive politike?!
Mirë! Atëherë,

Bazuar në nenin 23/4, pika 1 të Ligjit “Për Partitë Politike”, për partitë si vijon, do të vendoset sanksion në masën e 60 000 lekëve:

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;

Partinë Demokratike e Shqipërisë;

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;

Partia Socialiste të Shqipërisë;

Republikane të Shqipërisë;

Partinë Demokracia Sociale;

Partinë Ardhmëria Shqiptare;

Partinë Balli Kombëtar;

Partia Lëvizja Punëtoresh Shqiptare;

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë;

Partia Independentëve (Centriste) të Shqipërisë;

Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë;

Partia e Blertë Shqiptare


Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë;

Partia Nacional Demokrate Shqiptare;

Partia Universale Shqiptare;

Partia Uniteti Kombëtar;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

Partia Liberale Shqiptare

Partia Ekologjike;

Partia Lidhja Popullore Shqiptare;

Partia Socialpunëtore e Shqipërisë;

Partia Nacionaliste Shqiptare;

Partia Socialreformiste e Shqipërisë;

Partia Beslidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare;

Partia Lëvizja Demokratike për Vlera Mirëqenie Progres;

Partia Alternative Republikane;

Partia e Djathtë Demokratike e Shqipërisë;

Partia Drejtësia Shoqërore;

Partia Progresi Demokratik;

Partia Mbrojtja e të Drejtave Kombëtare;

Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar;

Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare;

Partia e Re Socialiste të Shqipërisë;

Partia Triumfi i Legalitetit;

Partia Ideali Demokratik Shqiptar;

Partia Rimëkëmbja Kombëtare;

Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare;

Partia Pajtimit Kombëtar;

Partia Lëvizja për Demokraci;


Partia Aleanca Demokracia e Re;

Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare;

Partia Qytetare Shqiptare;

Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë;


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

Partia Ideali Komunist;
Partia Komuniste Shqiptare (e Rindërtuar);
Partia e Punës e Shqipërisë;
Partia e të Majtës Demokratike Shqiptare;
Partia Ambientaliste;
Partia Aleanca Nacionale Shqiptare;
Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare;
Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare;
Partia Demokrate e Re;
Partia Demokracia Paqësore e Shqipërisë;
Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve;
Partia Aleanca Socialiste Shqiptare;
Partia Sigurisë Kombëtare Shqiptare;
Partia Shpresa Demokrate;
Partia e Biznesit Shqiptar;
Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori;
Partia Demokratike Peza Gjirokastër e Shqipërisë
Partia Integritit Social Kombëtar Shqiptar;
Partia Lidhja e Blertë Shqiptare;
Partia Aleanca Popullore për Drejtësi;
Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut;
Partia Shqiptare Atdheu;
Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare;
Partia e të Drejtave të Mohuara;
Partia e Çështjeve Shqiptare;
Partia Fronti i Majtë;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

Partia Shqipëria e Re;

Partia Lëvizja Elitare Kombëtare;

Partia Shqiptare e Rindërtimit;

Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare;

Partia e të Drejtave të Mohuara - e Re;

Partia Lista për Shqipëri Natyrore;

Partia Aleanca Kombëtare;

Partia Progresi Social Kombëtar;

Partia Aleanca për Europën;

Partia Demokratike e Bashkimit Myslyman të Shqipërisë;

Partia Ligj dhe Drejtësi;

Partia G 99;

Partia Toleranca e Re e Shqipërisë;

Partia Aleanca Europiane Ekologjike;

Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;

Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve;

Partia Personat me Aftësi të Kufizuar;

Partia Lëvizja Shqipëria e Re;

Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane;

Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres;

Partia Aleanca Kuq e Zi;

Partia Forca Rinia;

Partia Sfida për Shqipërinë;

Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare.

Këto ish-in, ndërkohë partitë vijuese do të sanksionohen bazuar në nenin 23/4, pika 2, për shkak të mosbashkëpunimit me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

ekspertëve kontabël, apo audituesve të KQZ-së në vlerën e 1 000 000 lekëve, sipas parashikimeve të nenit 23/4, pika 2 të Ligjit “Për Partitë Politike”. Partitë që marrin këtë sanksion në këtë vlerë janë partitë:

Partia e Djathtë Demokratike e Shqipërisë;

Partia Aleanca Kombëtare;

Partia Ligj dhe Drejtësi;

Partia Komuniste Shqiptare (e Rindërtuar);

Partia Komuniste e Shqipërisë;

Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë;

Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim;

Partia Demokrate e Re;

Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;

Partia Bindja Demokratike;

Partia Zgjidhja;

Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet;

Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen;

Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Shqiptar. Këto janë, faleminderit!

Vendimi nr. 38

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

**9.04.2024
Ora 12:19**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kristian Luigj Shkreli, kryetar bashkie në Bashkinë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj, z. K. Puleri.

Parti Politike: Z. M. Logu (Koalicioni “Bashkë Fitojmë”)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Në zbatim të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kryetari i Bashkisë”. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Kristian Luigj Shkreli, kryetar në Bashkinë Vau-Dejës, më datë 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 10052. KQZ bëri verifikimin paraprak dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zotit Kristian Shkreli, rezulton se ka deklaruar ndryshime në rubrikën e mbiemrit nga “Shkreli” në “Kola”, dhe më pas ka ndryshuar nga “Kola” në “Shkreli”. Gjithashtu ka deklaruar se është ndaluar për mungesë dokumentacioni në Torino. Ka deklaruar gjithashtu se ka jetuar për më shumë se 1 muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nisur nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme. Në datën 01.02.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Kristian Shkreli. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme, konstatohet se subjekti vetëdeklarues, zoti Kristian Shkreli, kryetar i Bashkisë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit ose moszgjedhshmërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Bazuar në kërkesën që bëri përfaqësuesi i subjektit të interesuar Koalicionit “Bashkë Fitojmë” i kërkuam Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, informacion në lidhje me atë nëse ka procedim penal të regjistruar ndaj këtij subjekti. Kemi marrë përgjigje nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në lidhje me këtë kërkesë dhe besoj se jeni njohur zoti Logu?! Sipas përmbajtjes së përgjigjes

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

rezultos se “Në emër të shtetasit Kristian Luigj Shkreli, kryetar i Bashkisë Vau-Dejës, nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Po!

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Faleminderit zoti Komisioner! Në fakt, nga studimi dhe analizimi që ne u kemi bërë të gjitha akteve që na janë vënë në dispozicion, vërejmë se të paktën ka tre probleme, të cilat janë shumë të rëndësishme. Ashtu siç po themi pa dashur të paragjykojmë punën e Prokurorisë së Përgjithshme, shohim që kemi të bëjmë me një verifikim, do të thosha, sipërfaqësor, megjithëse ligji imponon verifikim të thelluar. Nga rezulton ky lloj konstatimi nga ana jonë, sepse duket se informacioni është kërkuar nga ana jonë në atë lloj forme, për t’i rënë në kokë, të dhënave që janë deklaruar nga vetë subjekti. Psh, subjekti ka deklaruar për herë të parë në formularin e vitit 2023, data 20 mars 2023, duke qenë se ishte kandidat për kryetar i Bashkisë Vau-Dejës. Deklaron për herë të parë që “jam dëbuar më 10 prill 2007” dhe duket sikur puna verifikuese që ka kryer Prokuroria e Përgjithshme, Sektori i Dekriminalizimit, në bashkëpunim me Departamentin e Policisë Kriminale dhe më pas me Ministrinë e Drejtësisë, duket që ka qenë vetëm për të gjetur këtë vendim dhe jo për t’u marrë, apo siguruar në qoftë se ka për këtë subjekt edhe të dhëna të tjera. Të cilat në vlerësimin tonë, ose të paktën referuar të dhënave dhe indiceve që ne kemi si Parti Demokratike, ka më shumë se një vendim dëbimi dhe jo vetëm për arsye emigracioni, apo parregullsie dokumentacioni. Ashtu siç po themi, informacionet e tjera kanë ardhur edhe për përfshirjen në veprimtari të paligjshme të këtij subjekti në shtetin italian. Kështu që, i nderuar, në fakt do të ishte komplet logjike dhe e arësyeshme që në momentin që prokuroria përcjell vendimmarrjen e saj, të përcillte një praktikë të plotë të gjitha akteve, në mënyrë që kjo që po themi, të mos ishte thjesht aludim, po të kuptohej qartazi nga koorespondenca. Psh, unë vlerësoj se, padashur që kurrsesi të bëhemi


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

shkak për zvarritje të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që nuk është aspak qëllimi ynë... unë vlerësoj se do të ishte shumë e rëndësishme që Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe për rrjedhojë edhe subjekteve të interesuara, siç jemi ne në këtë rast, t'i vihej në dispozicion psh, koorespondenca që ka pasur Propuroria e Përgjithshme me Departamenin e Policisë Kriminale, qofshin kërkesat e nisura dhe përgjigjet e ardhura. Në këtë mënyrë do të shohim nëqs është kërkuar informacion specifik vetëm për atë deklaram që është bërë, apo hetimi do të duhej të përfshinte çdo lloj të dhëne, apo rekordi që ekzistonte, për këtë subjekt. Element tjetër i nderuar, që ne vlerësojmë se është i nevojshëm, për para se të konkludohet me vendimmarrje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është dhe koorespondenca shkresore që ka pasur Prokuroria e Përgjithshme me Ministrinë e Drejtësisë që ka funksionuar në këtë rast si ndërmjetës në mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë Italiane, në mënyrë që të shohim nga këto praktika që informacioni, apo verifikimi që është kryer ka qenë gjithëpërfshirës për çdo të dhënë që mund të ekzistonte, apo është kërkuar informacion specifikisht për atë të dhënë që vetë subjekti ka deklaruar. Pra, vendimin e dëbimit nga shteti italian të datës 10 prill 2007. Kjo është çështja e parë, i nderuar dhe unë vlerësoj se këto koorespondenca duhen administruar në këtë proces, në funksion të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ, në mënyrë që të kuptohet qartazi cilat kanë qenë veprimet verifikuese. Kjo për të vlerësuar se kanë qenë ato të mjaftueshme për të arritur një konkluzion të padyshimtë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që vërtet subjekti në fjalë nuk është në kushtet e ndalimit. Ka një element të po aq të rëndësishëm që duket se Prokuroria e Përgjithshme nuk është ndalur gjatë. Logjika normale, hetimore, verifikuese e kërkonte që të ndalej pak më shume. Në datën 10 prill 2007, subjekti është dëbuar nga Shteti Italian. Katër muaj më vonë, ky shtetas ndryshon mbiemrin. Në vendimin që në atë kohë është marrë nga strukturat e gjendjes civile të Komunës Bushat thuhet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

se “kështu figuroj në disa dokumenta”. Pra, ky shtetas pranon që herë përdorte një mbiemër dhe herë përdorte një mbiemër tjetër. Do të duhej që verifikimi, minimalisht të kryhej, ose të shihej me këtë mbiemër, apo mbiemrin tjetër e kështu me rradhë, pasur parasysh faktin që përgjithësisht nga praktika e mëparshme Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i ka rezultuar që ndryshimi i mbiemrit nga shtetas të caktuar bëhet pikërisht me qëllim për të shmangur ato sanksione që janë marrë më parë nga një shtet i caktuar. Më pas, pa ndonjë justifikim të arësyeshem, ka në vitin 2010 një tjetër ndryshim të mbiemrit, nga mbiemri i ri, kalohet sërish në mbiemrin e mëparshëm. Edhe ky element duket sikur.., nga vendimi që ka marrë Prokuroria e Përgjithshme, ka marrë vetëm një paragraf dhe nuk është thelluar më tej për të kuptuar në fakt që cila ka qenë arësyeja, apo motivet që kanë shtyrë këtë subjekt për të bërë një ndryshim mbiemri në një periudhë që përkon me vendosjen e një mase dëbimi nga Shteti Italian ndaj tij. Raste mund të citojmë pa fund, sepse shtetas shqiptarë që janë dëbuar nga shtete të huaja, vijnë në Shqipëri, ndryshojnë mbiemrin paisen me dokumenta të reja identifikimi në mënyrë që të lejohen sërish të futen në territorin e këtyre vendeve. Mbase po të ndiqej kjo rrjedhë logjike, në fakt Prokurorisë së Përgjithshme, mund t’i rezultonte ajo që po themi që është një informacion që ne na është konfirmuar më shumë se nga një burim që ka më shumë se sa një masë dëbimi ndaj këtij subjekti dhe jo vetëm për çështje emigracioni, por dhe për cënim të rendit dhe sigurisë publike në shtetin italian. Element tjetër i rëndësishëm, që ka të bëjë dhe me hetimin penal., pse po themi do duhen verifikuar të gjitha këto informacione? Qartazi kemi të bëjmë me një subjekt që ka tendencë për të fshehur të dhëna, ose për të mos bërë deklaram të saktë. Kemi formularin e dekriminalizimit, ose formularin e vetëdeklarimit të dorëzuar më 6 maj 2019. Në rubrikën “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, në faqen 5, ky subjekt deklaroi “JO”, për një masë dëbimi që kishte marrë në vitin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

2007. Të njëjtin deklaram e gjejmë dhe në formularin e vetëdeklarimit që është bërë në 2 mars të vitit 2021, “A është marrë për ju ndonjë masë dëbimi nga ndonjë shtet i huaj?” “JO”. Për të njëjtën pyetje në vitin 2023, thotë “PO”. Kujtohet çuditërisht dhe jo vetëm kujtohet që ka një masë dëbimi, kujton dhe datën e saktë të kësaj vendimmarrje 10 prill 2007, qytetin ku është dhënë dhe arësyen sipas tij, mbase me idenë që kësaj here nuk mund t’i shpëtonte siç i kishte shpëtuar në dy rastet e mëparshme ku kishte qenë kandidat jo fitues për zgjedhjet vendore dhe zgjedhjet parlamentare. Sigurisht, po themi, megjithëse mua më habiti pak përgjigjja që ka ardhur nga Prokuroria e Posaçme, se përgjigje që ka ardhur në të cilën citohet shumë qartë se ka një kallëzim penal të regjistruar për këtë shtetas. Ka një procedim penal të regjistruar fillimisht nga Prokuroria e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, me numër 3377, të vitit 2023, për veprën penale të parashikuar nga neni 190 “falsifikim i vulave, stampave, ose formularëve”. Në përgjigjen që Prokuroria e Posaçme i ka kthyer Prokurorisë së Përgjithshme është regjistruar një procedim penal me numër 253, datë 29.12.2023 për vepërën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “falsifikim i vulave, stampave, ose formularëve”. Thënë këto i nderuar, unë mendoj se është e nevojshme që përpara se të konkludohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me një vendimmarrje të administrohen koorespondenca shkresore që Prokuroria e Përgjithshme ka pasur me Departamentin e Policisë Kriminale, për sa i përket kësaj praktike verifikimi. Të administrohet koorespondenca që Prokuroria e Përgjithshme ka pasur me Ministrinë e Drejtësisë. Shkresat janë të cituara në qoftë se është e nevojshme, mund edhe t’i citojmë shprehimisht. Për sa i përket kësaj procedure verifikimi, nga ana tjetër të administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile vendimet përkatëse për ndryshimet e mbiemrit, fillimisht nga “Shkreli” në “Kola”, pastaj nga “Kola” në “Shkreli”, sepse ka një seksion në atë vendimmarrje se pse bëhet ky lloj ndryshimi.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

Nga ana tjetër vlerësojmë se Prokuroria e Posaçme duhet pyetur shprehimisht, se s informacioni që përcillet nga Prokuroria e Përgjithshme është i pasaktë, ose informacioni i përcjellë nga Prokuroria e Posaçme është i pasaktë. Se dy informacione të ndryshme, njëri që thotë “nuk kemi të regjistruar gjë” dhe tjetri që thotë “kemi të regjistruar” të dyja nuk mund të qëndrojnë njëkohësisht. Pra, ose ka një procedim penal të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme dhe kjo çështje po hetohet dhe duhet parë se në çfarë faze është hetimi, ose pastaj Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë një informacion të pasaktë dhe duhet parë se ku ka mbetur kjo çështje. Po e ritheksoj këtë, i nderuar, se sigurisht kjo mbase del pak jashtë objekti të këtij shqyrtimi administrativ po ka dhe një afat parashkrimi për këtë vepr penale që për ne si subjekt politik është i rëndësishëm. Askush të mos përfitojë thjesht dhe vetëm sepse kanë tejkaluar afatet e parashkrimit të kryerjes së një vepr penale. Një vepr penale që qartazi rezulton se është kryer më shumë se njëherë të paktën në dy raste, në vitin 2019 dhe në vitin 2021. Me aq informacion sa ka këtu dhe nga mënyra se si ky informacion është transmetuar e ripërsëris dhe njëherë duket se Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar thjesht dhe vetëm të konfirmojë ato të dhëna, ose atyre të dhënave të cilave Sektori i Dekriminalizimit, pra i Prokurorisë së Përgjithshme, i ka kërkuar t’i verifikojë. Ose atyre të dhënave që ka deklaruar vetë subjekti, t’u bashkëlidhë një dokumentacion të caktuar. Nuk ka bërë një thellim të mëtejshëm nëse ka të dhëna të tjera të këtij personi me gjeneralitete të ndryshuara etj. etj., kështu me rradhë. Në vlerësimin tonë janë, por që duhet të ketë një verifikim të thelluar. Unë besoj se një shkresë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë për të marrë thjesht vendimin e datës 10 prill 2007, mund ta bënte edhe vetë KQZ-ja. Pastaj do të binte ai rol që ligji mbi dekriminalizimin i ka dhënë Prokurorisë së Përgjithshme për të verifikuar çdo informacion, çdo të dhënë që rezulton për një shtetas subjekt i ligjit, aq më tepër që kemi të bëjme me një subjekt që ushtron mandat të zgjedhuri

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

vendor, si Kryetar i Bashkisë së Vau-Dejës. Këto janë kërkesat që ne kemi zoti Komisioner dhe do të kërkonim që të vlerësoheshin si të drejta, pra të pranoheshin në mënyrë që mos ta kalojmë këtë çështje me aq informacion sipërfaqësor, që na është vënë në dispozicion nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Logu. Atëhere pikë së pari, në lidhje me kualitetin e përgjigjes në substancë të përgjigjes të organit të Prokurorisë së Posaçme, pra të SPAK, mendoj që kërkesa që ne i kemi adresuar bazuar në kërkimin tuaj ka qenë e qartë, besoj. Ne i kemi kërkuar dhe i themi “të na bëni me dije nëse ka procedim penal...” ashtu siç u kërkuar. “... nëse ka procedim penal të regjistruar në ngarkim të shtetasit Kristian Luigj Shkreli, kryetar i Bashkisë Vau-Dejës”. Kemi marrë përgjigje nga Prokuroria e Posaçme, pra nga SPAK dhe përgjigjja është e qartë. “Nuk rezulton që në emër të zotit Kristian Luigj Shkreli, kryetar në Bashkinë Vau-Dejës, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal”. Kam përshtypjen që më shumë se kaq nuk kishim se çfarë të kërkonim dhe më shumë se kaq sa janë përgjigjur, ata nuk ka pasur se çfarë mund të shtonin. Ndaj për këtë pikë besoj se jemi të qartë. Në lidhje me kërkesat e bëra nga ana juaj mendoj që përgjigjia që ka ardhur nga Prokuroria e Posaçme nuk është se solli ndonjë rrethanë të re, po e nis nga kjo pikë aryetimin tim në lidhje me kërkesën tuaj, e cila ose të cilat juve ju vendosën në pozitën për të bërë këto kërkime të reja. Pasi në thelb këto kërkime lidhem me çfarë organi i Prokurorisë së Përgjithshme ka kryer deri tani në kuadër të hetimit të thelluar. Përtej kësaj pavarësisht se kush ka qenë nxitësi për ju për të paraqitur këtë kërkesë, mendoj që në thelb kjo kërkesë, apo ato kërkesa që ju prezantuat, nuk janë të bazuara pasi ne nuk mund të bëjmë një vlerësim të vlerësimit apo se si e ka përmbushur këtë përgjegjësi organi i Prokurorisë së Përgjithshme. Pra, se si e ka bërë këtë hetimin e thelluar. Ne e marrim të mirëqenë rezultatin e këtij verifikimi dhe japim gjykimin

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

dhe vlerësimin tonë mbi atë rezultat. Unë mendoj se nuk mund të japim gjykime e vlerësime mbi atë sesi ata kanë arritur në këtë konkluzion, duke kërkuar komunikimet që organi i Prokurorisë së Përgjithshme ka pasur me institucione të tjera, qoftë brenda vendit, apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë...

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Që mos të keqkuptohemi. Së pari, nuk ishte shkresa e SPAK-ut indicie si me thënë...

Z. I. Celibashi: Jo s’ka problem, edhe nëse ishte..

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Sepse nuk është se ne kemi mbajtur qëndrim më parë për të gjitha dokumentat që na janë vënë në dispozicion...

Z. I. Celibashi: Për atë të SPAK-ut thjesht për ta sqaruar, edhe një herë që kërkesa jonë ishte e qartë dhe përgjigjja ishte e qartë, ka apo nuk ka regjistrim...

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Nga ajo e SPAK-ut lindi e gjithë historia tjetër, e para. E dyta, po të shohim te vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme do të shohim që ata thonë “ka një procedim penal që është regjistruar etj., etj.” e kështu me rradhë, qoftë në cilësinë.., sepse ju e dini, për shkak të eksperiencës, që në hetimet penale ke tre cilësi. Mund të jesh personi që të atribuohet vepra penale, mund të jesh personi nën hetim ku të regjistrohet emri, apo mund të jesh i pandehur.

Z. I. Celibashi: Sot kemi këtë të dhënë. Sot kështu e kemi!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Të paktën po themi që informacioni që vjen nga Prokuroria e Përgjithshme, konfirmon që është person që i atribuohet vepra penale, e dimë që e dhëna si person nën hetim regjistrohet më vonë, por nuk ka rëndësi. Kurse, përsa i përket, i nderuar, kërkesave që ne bëjmë, mendoj që lidhet një element i rëndësishëm, se pastaj të jesh..., roli i KQZ-së, thjesht e merr të mirëqenë atë që ka thënë Prokuroria e Përgjithshme shpall vendimin. Unë mendoj që atë vendim mund ta merrte edhe vetë Prokuroria e Përgjithshme dhe nuk ka nevojë që të bëjmë dublikim të kompetencave. Pra, nëse KQZ nuk bën një lloj hetimi vetadministrativ duke marrë disa burime të dhënash, unë pastaj them që thjesht kemi dublikim të kompetencave, nuk besoj se ka qenë ky qëllimi i ligjit. Mund ta shpallte thjesht Prokuroria e Përgjithshme. Mund të dilte drejtuesi i Sektorit të Dekriminalizimit dhe shpallte personin “nuk është në kushte të ndalimit” dhe vazhdonte gjithë pjesa tjetër. KQZ nuk mund t’ia mohojë vetes të drejtën që ka, për të kryer një hetim të plotë administrativ, kur është rasti për një verifikim të thelluar të një subjekti të caktuar. Prokuroria..., askush nuk është i pagabueshëm dhe nuk mund të merret që kështu që ...e mirëqenë në çdo rast.

Z. I. Celibashi: Në vlerësimin tonë jemi duke bërë pikërisht një shqyrtim të thelluar administrativ. Pjesë e këtij shqyrtimi të thelluar në këtë rast është pikërisht dhe kërkesa dhe marrja e përgjigjes e bazuar në këtë kërkesë tonën, drejtuar organit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe përgjigjja e organit të Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me çfarë i kemi kërkuar. Ata kanë sjellë një përgjigje. Unë mendoj se këtu mbaron atributi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në raport me çfarë paraqet Prokuroria e Përgjithshme. Kjo është një praktikë që kështu e ka mbajtur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ne nuk i hyjmë dhe nuk mund t’i hyjmë, të paktën në vlerësimin që ne i bëjmë dispozitave përkatëse të ligjit, vërtetësisë së asaj që vjen

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme, të informacionit që vjen. E marrim ashtu të mirëqenë. Është e njejtë për analogji, nëse organi i Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me cilësimin e një veprë penale që një shtetas i Republikës së Shqipërisë ka kryer në një territor të huaj, janë ata që na thonë ne, “kjo vepër penale e kryer në këtë territor është kjo vepër penale sipas Kodit Penal Shqiptar”. Përndryshe do të duhej që të bënim ne një vlerësim të përputhshmërisë së veprës penale që është kryer në territorin e një shteti tjetër në dispozitën përkatëse në Kodin Penal Shqiptar. Ky është atributi i organit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe është atribut që ja ka dhënë ligji. E solla këtë si shembull për të thënë që në tërësi çfarë ata konkludojnë ne e marrim të mirëqenë dhe japim vlerësimin dhe gjykimin tonë. Ndaj për ta përfunduar se mendoj që mjaftueshëm e debatuar këtë, por gjithsesi nëse keni ndonjë gjë më shumë për të thënë... Mendoj që kërkesat tuaja nuk mund të pranohen.

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Ky është vlerësimi juaj zoti Komisioner dhe vendimarrja juaj të cilën ne më pastaj do ta vlerësojmë, pasi të zbardhet. Unë mendoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo vërtetësinë, por thellësinë.., ose se si është realizuar verifikimi mund ta vlerësojë.


Z. I. Celibashi: E mbyllem këtë diskutim

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Jo se mbyllem se..,

Z. I. Celibashi: E mbyllem se muarëm vendim për këtë gjë.

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Po tani i bie që vendimi juaj tjetër është i paragjykuar. Nëse ju shpallni vetëm atë që ju thotë Prokuroria e Përgjithshme,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*


këtu bie funksioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Se çfarë shqyrtimi administrativ kryem ne, se më duket si ato hetimet e Prokurorisë që i bëjnë një shkresë një institucioni dhe thonë “jemi në rregull se vendosa pushimin e procedimit penal”. I nderuar unë mendoj vërtetësinë dhe profesionalizimin...

Z. I. Celibashi: Kështu e ka vendosur ligji.

Z. M. Logu, përfaqësues i Koalicionit “BF”: Mendoj që thellësinë ose mënyrën se si është bërë ky verifikim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet ta vlerësojë, edhe praktikën bashkë me vendimin. Të sjellë gjithë praktikën e korespondencave dhe mendoj se do të ishte krejt korrekte në mënyrë që të shihet hap pas hapi se si është kryer ky proces. E ripërsëris që në vlerësimin tim ose tonë, duket sikur është kërkuar “na vini në dispozicion vendimin e datës 10.04.2007”. Është dhënë vendimi dhe ky vendim thotë “që nuk është në kushtet e ndalimit”. Detyra e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu si besoj edhe e Prokurorisë së Përgjithshme duhet të jetë në çdo rast, të zbardhë të vërtetën. Jo të mbetet peng i procedurës burokratike. Një e vërtetë që mund të jetë dhe kështu si është sot në realitetin e gjërave, një e vërtetë që mund të jetë edhe ndryshe. Megjithatë nëse vlerësimi juaj është që marrim shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme na thonë që s’ka probleme, themi që s’ka probleme, na thonë që ka probleme, themi që ka probleme. Unë besoj që KQZ-ja humbet nga roli që ka në këtë lloj procesi dhe interpretimi jonë dhe bindja jonë është që KQZ-ja ka një rol shumë më të madh në këtë proces se sa kaq.

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Logu. Mesa u kuptuam nuk kemi gjë tjetër. Atëherë, për ta përfunduar, ne konstatojmë se:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.04.2024*

- Zoti Kristian Luigj Shkreli, kryetar i Bashkisë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të kryetarit.
 - Vazhdimin e mandatit të zotit Kristian Luigj Shkreli si kryetar i Bashkisë së Vau-Dejës.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe,
 - Mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.
- Faleminderit, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 39

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

